



Prishtinë, 03 prill 2015
Kodi i ZRRE: V_722_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën paragrafin 1.6, Nenin 14, paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së);
- Vendimin nr. V_718_2015 për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për OSSH;
- Metodologjia e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes; dhe
- Kërkesën e datës 30 mars 2015 të KEDS –it dorëzuar ZRRE për miratimin e ngarkesave të rregullura të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur më 03 prill 2015 nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifat dhe ngarkesat, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) për vitin relevant tarifor apo SHTE9, i cili fillon nga 1 prilli 2015.

ARSYETIM

- o Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes(KEDS), më datën 31 mars aplikacionin për ngarkesa të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes(DUOS);
- o Për vendosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen e saj si dhe takimet sqaruese që ka mbajtur me të licencuarit gjatë periudhës së shqyrtimit tarifor 2015. Këto dokumente janë:
- Raport Konsultativ - Kalkulimi i Kostos së Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 09 Mars 2015;
- Raport Konsultativ - Kalkulimi i MAR-it të OSSH , i publikuar më datën 09 Mars 2015; dhe




- Përgjigjet ndaj Komenteve - Shqyrtimi i nëntë i tarifave të energjisë elektrike SHTE9, i publikuar me datën 03 prill 2015;
- II. Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Struktura e ngarkesave për OSSH, që do të zbatohet nga data 1 prill 2015, përkatësisht në vitin relevant tarifar SHTE9 është dhënë në tabelën e mëposhtme.


Ngarkesat e konsumatorëve të kyçur në OSSH		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€c/kWh	1.34
10 kV	€c/kWh	1.61
0.4 kV	€c/kWh	2.39


- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE:


Enver Halimi, Kryesues


Merita Kostari, Anëtare


Krenar Bujupi, Anëtar